



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

02. Nr. 423/2011
Dt: 20.09.2011

Duke u bazuar në, Ligjin e shërbyesve Civil nr 03/L-149 neni 11, neni 18 paragrafi 1, Rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010, si dhe pas miratimit dhe autorizimit për rekrutim nga Ministria e Administratës Publike nr. 592, Komuna Hani i Elezit Shpall këtë:

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës: Shofer i Administratës komunale dhe mbikqyrës i automjeteve
Drejtoria e Administratës

Kategoria dhe grada : (koeficienti 6)¹

Kohëzgjatja e kontratës: periudha provuese një vjeqare

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Bën kontrollimin e të gjitha automjeteve të administrates komunale
- Koordinon punët me zyrtarët e administrates së komunës në lidhje me udhëtimet e tyre zyrtare
- Është përgjegjës për kontrollimin, plotësimin dhe vulosjen e fletudhtimeve të veturave zyrtare
- Është përgjegjës për sigurimin e fletudhtimeve zyrtare, në rast të mungesës së tyre
- Është përgjegjës për servisimin e veturave dhe për regjistrimin e tyre me rastin e skadimit
- Kryen edhe punë të tjera me urdhër të eprorit sa i përket vendit të punës

¹ Kategoria dhe grada për këtë pozitë do të përcaktohet me nxjerrjen e aktit nënligjor nga Ministria e Administratës Publike

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim: Kandidatët për këtë vend pune duhet ti plotësojnë këto kushte:

- Të kenë të kryer shkollën e mesme
- Aftësi për të krijuar raporte të mira pune dhe ndërpersonale
- Aftësi të mira komunikimi në të shkruar dhe në të folur
- Referencë, mirënjohje apo certifikatë të ndonjë institucioni apo organizate
- Të jetë i aftë të kryej detyrën si shofer i administratës komunale
- Preferohet të ketë përvojë pune
- Të posedoj patent shofer

Kërkesat specifike:

- Dëshmi mbi kryerjen e obligimeve komunale

Procedura e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për gjithë kandidatët e jashtëm.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin e Shërbyesve civil dhe rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010 e cila e rregullon rekrutimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik. Formularët e aplikimit mund të merren në zyrën e pritjes, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00 dhe do të dorëzohen po ashtu në zyrën e pritjes në objektin e Komunës kati i parë.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Kopjen e vërtetuar të Diplomës së shkollës së mesme, kopjen e letërnjoftimit, kopjen e patent shoferit, certifikatën e lindjes si dhe certifikata mbi trajnimet e kryera.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor.

Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjestarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”



**Kryetari i Komunës
Rufki Suma**